



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 08 Mars 2021

Nr: 119

VENDIM

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT TË PUNËS QË DO TË PËRDORIN  
KOMISIONET E QENDRAVE TË VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E  
SHQIPËRISË TË DATËS 25 PRILL 2021

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronjat “b” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V Ë R E N

Komisioni i Qendrës së Votimit (KQV), përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit sipas dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore të nxjerra nga KQZ. KQV, në përmbushje të detyrave sipas parashikimeve të nenit 42 e vijues të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar:

1. Regjistron në librin e protokollit të mbledhjeve:

a.vendimet e KQV-së;

b.kërkesat, ankesat dhe njoftimet drejtuar KQV;

c.marri në dorëzim të materialeve zgjedhore nga KZAZ-ja;

ç.vërejtjet që vëzhguesit i paraqesin KQV-së;

d. shënon numrat e kodeve të sigurisë me të cilat vulozet kutia e votimit dhe kutia e materialeve zgjedhore, dhe numri i kodit të sigurisë së vulës së dëmtuar dhe numri i kodit të sigurisë të vulës shtesë;

dh. procesverbalet e mbledhjeve të KQV-së;

e. kërkesat që të tretët i paraqesin KQV-së;

ë. rastet e parashikuara në nenet 107 dhe 109, paragrafi 2;

f. rastet kur në qendrën e votimit rrezikohet rendi ose zhvillimi i rregullt i votimit;

g. kohën e largimit dhe të kthimit të kryetarit apo të sekretarit të KQV, anëtarit i cili ka në përdorim vulën e kryetarit apo sekretarit;

gj. rastet e dëmtimit apo nxjerrjes jashtë qendrës së votimit të vulës së QV-së, të vulës së



Data: 08 Mars.2021

Nr. 119

Për miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës që do të përdorin Komisionet e Qendrave të Votimit, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021

- kryetarit të KQV-së, dhe të zëvendësimit me vulën rezervë;
- h. përcaktimin e shifrës për numrin e personave që kanë votuar në rast kundërshtimesh nga anëtarët e KQV-së;
  - i. numrin e plotë të fletëve të votimit të qendrës së votimit, numrin i fletëve të votimit të papërdorura, numrin e fletëve të votimit të dëmtuara;
  - j. orën e mbylljes së votimit.
2. Përdor Regjistrin e Posaçëm të Zgjedhësve, sipas përcaktimeve të nenit 105, paragrafi 3, të Kodit Zgjedhor.
3. Merr vendim për:
- a. caktimin e detyrave të anëtarëve të KQV;
  - b. hapjen e votimit;
  - c. largimin e personave të caktuar nga mjediset e qendrës së votimit;
  - ç. pezullimin e votimit;
  - d. kërkimin e ndihmës nga Policia e Shtetit për rivendosjen e rendit në qendrën e votimit;
  - dh. largimin e punonjësit të policisë pas rivendosjes së rendit në qendrën e votimit;
  - e. mbylljen e votimit;
  - ë. përcaktimin e numrit të personave që kanë votuar në qendrën e votimit në rast kundërshtimi.
4. Dokumenton në procesverbal;
- a. pezullimin e votimit;
  - b. rifillimin e votimit;
  - c. vulosjen e kutisë së votimit;
  - ç. mbylljen e votimit.

#### PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronjat “b” dhe “n”, paragrafi 2, nenin 42 e vijues të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

#### VENDOSA:

1. Të miratoj dokumentacionin e punës që do të përdorin Komisionet e Qendrave të Votimit, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, si më poshtë:
  - 1.1 Libri i protokollit të mbledhjeve të KQV-së;
  - 1.2 Regjistri i posaçëm i zgjedhësve;
  - 1.3 Për administrim të dokumentacionit, materialit zgjedhor dhe marrjen e vendimeve:



Model KQV 1 zarfi “Procesverbal i vulosjes së kutisë së votimit;  
Model KQV 2 zarfi “Fletë votimi të papërdoruar”;  
Model KQV 3 zarfi “Fletë votimi të dëmtuara”;  
Model KQV 4 zarfi “Vërtetime të identifikimit elektronik të zgjedhësit”;  
Model KQV 5 “Procesverbal i pezullimit të votimit”;  
Model KQV 6 “Procesverbal i rifillimit të votimit”;  
Model KQV 7 “Procesverbal i vulosjes së kutisë së kutisë së votimit”;  
Model KQV 8 “Procesverbal i mbylljes së votimit”;  
Model KQV 9 “Procesverbal i vulosjes së kutisë së pasisjes së identifikimit elektronik të zgjedhësve”;  
Model KQV 10 Vendim “Për caktimin e detyrave të anëtarëve të KQV-së”;  
Model KQV 11 Vendim “Për hapjen e votimit”;  
Model KQV 12 Vendim “Për largimin e personave të caktuar nga mjediset e Qendrës së Votimit;  
Model KQV 13 Vendim “Për pezullimin e votimit;  
Model KQV 14 Vendim “Për kërkimin e ndihmës nga policia për rivendosjen e rendit në QV”;  
Model KQV 15 Vendim “Për largimin e punonjësit të policisë nga Qendra e votimit”;  
Model KQV 16 Vendim “Për mbylljen e votimit”;  
Model KQV 17 Vendim “Për përcaktimin e numrit të personave që kanë votuar në QV”.

1.4 Specifikimet teknike sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Kopje: 3  
Afati ruajtjes: 3 vjet  
Punoi:  
B.Bego \_\_\_\_\_  
A.Tenolli \_\_\_\_\_  
M. Çelmeta \_\_\_\_\_  
Y.Merkaj \_\_\_\_\_

Nr. \_\_\_\_ prot.

Tiranë më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2021

